

VENDIM
Nr. 619, datë 12.9.2012

PËR NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË REZERVUARIT TË FARKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 6 të vendimit nr. 567, datë 14.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e rezervuarëve dhe skemave ujitëse përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1157, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e destinacionit të përdorimit të rezervuarit të Farkës, nga rezervuar uji për nevojat e bujqësisë, në rezervuar uji për nevojat e bujqësisë dhe furnizimin me ujë të pijshëm, për familjet e komunës Farkë.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe komuna Farkë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha